

V E N D I M
Nr.522, datë 21.8.1998

**PËR MIRATIMIN E PLATFORMËS PËR RISTRUKTURIMIN E SHËRBIMIT
KËSHILLIMOR BUJQËSOR**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e platformës për ristrukturimin e shërbimit këshillimor bujqësor.
 2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për zbatimin e kësaj platforme.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PLATFORMA E RISTRUKTURIMIT TË SHËRBIMIT KËSHILLIMOR BUJQËSOR

1. Shërbimi këshillimor dhe roli i tij

Shërbimi këshillimor është një instrument i rëndësishëm për transferimin e njohurive tek fermerët për t'i mbështetur ata në zhvillimin e fermës me shërbime të karakterit teknik e menaxhues, të cilat mundësojnë rritjen e prodhimit dhe të të ardhurave. Ai është gjithashtu instrument për realizimin e politikave dhe strategjisë kombëtare bujqësore. Në këtë vështrim shërbimi këshillimor mund të luajë një rol të madh në fuqizimin dhe modernizimin e sektorit bujqësor në Shqipëri.

Shërbimi këshillimor përbën një proces edukimi që përhap njohuritë në fermë nëpërmjet rrugëve të ndryshme të kontakteve midis specialistëve dhe fermerëve, demonstrimeve në fushë, kontakteve të fermerëve me njëri-tjetrin, nëpërmjet masmedias etj.

2. Gjendja aktuale dhe faktorët që e bëjnë të domosdoshëm ristrukturimin e shërbimit këshillimor.

Në vendin tonë shërbimi këshillimor, si një strukturë e veçantë, ka filluar që në vitin 1993 si fazë pilot, në gjashtë rrethe dhe aktualisht janë inkluduar në këtë shërbim 26 rrethe.

Për këtë periudhë shërbimi ka pasur si objektiv:

Të ngrejë në të gjithë vendin një shërbim këshillimor publik me efektivitet, që jep këshilla falas për bujqit e vegjël dhe të mesëm, duke iu përgjigjur nevojave të tyre teknike dhe ekonomike në procesin e integritit të tyre në ekonominë e tregut.

Shërbimi këshillimor organizohet dhe drejtohet nga MBU-ja nëpërmjet Drejtorisë së Shkencës dhe Shërbimit Këshillimor (sektori i shërbimit këshillimor).

Disa drejtori teknike të MBU-së përfshihen në strukturën publike të shërbimit këshillimor, por pa një koordinim të qartë dhe platformë të përbashkët.

Në nivel rrethi në drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit funksionon sektori i shërbimit këshillimor me numër të reduktuar specialistësh, të cilët njëkohësisht janë të ngarkuar edhe me detyra të tjera teknike të caktuara nga drejtoritë teknike të MBU-së.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për specialistët që punojnë në nivel komune.

Midis kërkimit dhe shërbimit këshillimor, me gjithë përpjekjet e bëra, ende nuk është vendosur një lidhje e qëndrueshme dhe efektive.

Krahas shërbimit këshillimor publik operojnë edhe organizma të tjera private të cilët tregojnë shumicën e imputeve në bujqësi dhe blegtori dhe po angazhohen gjithnjë e më tepër në prodhimin dhe importimin e farnave.

Ndërkohë shoqata të ndryshme agrobiznesi dhe prodhuesish po bëhen gjithnjë e më aktivë.

Faktorët kryesorë që në kushtet aktuale diktojnë nevojën e ristrukturimit të shërbimit këshillimor janë:

Pamundësia që shteti të mbajë në të ardhmen një shërbim këshillimor tërësisht publik, kostoja e të cilit është mjaft e lartë; shkurtimi i numrit të punonjësve buxhetorë, fakti që organizmat private dhe shoqatat joqeveritare mund të kryejnë një shërbim këshillimor më efektiv dhe aq më tepër që fermerët në përgjithësi i kushtojnë pak vëmendje shërbimit këshillimor falas janë argumente të fuqishëm, që diktojnë nevojën e ristrukturimit të shërbimit këshillimor publik dhe orientimin e tij drejt një privatizimi gradual.

Nga ana tjetër, donator të ndryshëm si Banka Botërore etj., u rekomandojnë qeverive të reformojnë sistemet jo shumë adekuate për nevojat e fermerëve dhe që janë problematike nga ana financiare.

Aktualisht nga Buxheti i Shtetit mbulohen vetëm pagat e stafit të shërbimit këshillimor dhe disa shpenzime të tjera të vogla.

Kushtet e punës për stafin e shërbimit këshillimor janë të vështira dhe karakterizohen nga pagat e ulëta, mundësi të kufizuara të transportit dhe të komunikimit. Gjithashtu të kufizuara janë mundësitë për njohjen e teknologjive të reja, materialeve referuese dhe burimeve të tjera të informacionit.

Numri i stafit të shërbimit këshillimor në raport me vështirësitë konkrete dhe detyrat që duhet të përballojë ky shërbim aktualisht është i vogël (një punonjës këshillimi për më shumë se 1000 ha dhe madhësia mesatare e fermës është 1,1-1,3 ha), ndërkohë që mbetet tendencë reduktimi i numrit të punonjësve të sektorit publik. Kjo situatë vështirësohet edhe nga përdorimi i kufizuar i teknikave të masmedias, shkalla e ulët e organizimit të fermerëve etj.

3. Strategjia e re dhe aktivitetet që do të ndërmerren

Në kuadrin e strategjisë kombëtare bujqësore objektivi i shërbimit do të jetë:

Fuqizimi dhe shtrirja e këtij shërbimi në të gjithë vendin e lidhur ngushtë me sektorin privat, si dhe ristrukturimi duke synuar privatizimin gradual të tij.

Sipas “strategjisë së gjelbër” deri në vitin 2000 do të përfundojë shtrirja e shërbimit publik në të gjithë vendin, me përfshirjen në këtë strukturë edhe të 10 rrethëve të tjera.

Shërbimi këshillimor efektiv do t’i përgjigjet nevojave të fermerëve për të specializuar dhe rritur prodhimin, si dhe për të siguruar të ardhura më të mëdha nga fermat e tyre. Nëpërmjet tij do të realizohet komunikimi ndërmjet strukturave shtetërore, kërkimit shkencor, fermerëve dhe biznesmenëve privatë. Metoda për të njohur më mirë

problemet dhe mundësitë e fermerëve, përcaktimi i qartë i grupeve target, identifikimi i teknologjive të reja, metodat efektive të përhapjes së njohurive (përfshirë masmedian) dhe ndarja e detyrave ndërmjet shërbimit këshillimor publik dhe atij privat, përbëjnë elementet kryesore të kësaj strategjie.

Në aspektin organizativ, në nivel qendror të gjitha aktivitetet që lidhen me shërbimin këshillimor publik do të përqendrohen në një drejtori të vetme në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit që do të ketë lidhje të ngushta me drejtoritë teknike dhe kërkimin shkencor. Në këtë linjë do të riorganizohen edhe strukturat e shërbimit këshillimor në drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit në rrethe deri në nivel komune.

Për të realizuar detyrat, stafi i shërbimit këshillimor do të pajiset me të gjitha fasilitetet e domosdoshme, do të trajnohen mirë dhe orientohen drejt specializimit. Këshillat e përgjithshme (standarde) është më efektive të përhapen nëpërmjet teknikave të masmedias (radio, TV, fletëpalosje, artikuj etj.), ndërkohë që puna me grupe, demonstrimet në fermë etj., duhet të përdoren për këshilla më të specializuara për të përhapur teknologjinë e përshtatshme prej fermerëve më të suksesshëm, si dhe për të futur teknologjitë e reja dhe mbështetur organizimet e fermerëve.

Në aspektin financiar, tendenca e privatizimit gradual të shërbimit këshillimor do të sjellë në të ardhmen pakësimin e kontributit financiar nga Buxheti i Shtetit, por për një periudhë transitore ky kontribut do të jetë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.

Aktualisht dhe në perspektivën e afërt, fermerët tanë mund të karakterizohen në 2 grupe:

Grupi i parë: Fermerë që prodhojnë kryesisht për treg. Ky grup është i shtrirë kryesisht në zonat fushore, në ato rreth qyteteve dhe qendrave të mëdha të banuara, ku shkalla e intensifikimit të

prodhimit është relativisht e lartë.

Grupi i dytë: Fermerë që prodhojnë për nevojat e veta. Ky grup i përket kryesisht zonave të largëta kodrinore e malore, përgjithësisht të varfra.

Objekti kryesor i shërbimit këshillimor të specializuar do të jetë pikërisht grupi i parë, ku do të interferojnë edhe elementë ose struktura të shërbimit këshillimor privat duke tentuar në të ardhmen drejt këtij të fundit.

Ndërsa për grupin e dytë do të zhvillohet një këshillim i përgjithshëm (jo shumë intensiv) në kuadrin e një strukture publike.

Në funksion të kësaj ideje, do të jetë krijimi i qendrave rajonale të këshillimit në zonën me potenciale të bujqësisë (rreth 13 rrethe) nisur nga mundësitë reale të realizimit (ambientet në dispozicion të instituteve kërkimore rajonale, si dhe ndihma që mund të ofrojnë projekte të ndryshme nëpërmjet fondeve dhe asistencës teknike për ngritjen e konsolidimin e tyre).

Krijimi i këtyre qendrave shihet si një zgjidhje racionale dhe strukturë efikase që krijon edhe premisat e privatizimit të këtij aktiviteti për të ardhmen. Si hap i parë në këtë drejtim do të jetë krijimi i një qendre të tillë si projekt pilot.

Për të realizuar këshillim të specializuar, qendra në përbërjen e saj do të ketë një staf të kualifikuar specialistësh në përshtatje me specifikat e rajonit, si dhe specialistë për marketingun, për kërkim-këshillimin etj. Qendra do të pajiset me mjete komunikimi, transporti, publikimi, fasilitete trajnimi, bibliotekë dhe laboratorë të thjeshtë diagnostikimi.

Qëllimi i ngritjes së këtyre qendrave do të jetë:

- të krijohet një strukturë e shërbimit këshillimor më e decentralizuar dhe më efektive nga pikëpamja financiare (fermerët do të fillojnë të paguajnë gradualisht për asistencën teknike që marrin);

- të rritet koordinimi i shërbimeve të ndryshme bujqësore publike dhe private;
- të përmirësohet përmbajtja teknike e këshillimit nëpërmjet specializimit dhe orientimit më të mirë drejt prodhimit si, dhe futjes së teknologjive të reja specifike për kushtet agroekologjike të rajonit;

- të krijohet mundësia që të kryhen më mirë shërbime të veçanta laboratorike që nuk mund të realizohen në nivel rrethi.

Aktivitetet dhe përgjegjësitë e këtyre qendrave përfshijnë:

- trajnimin e stafit të shërbimit këshillimor bazuar në principin e trajnimit të trajnuesve;

- identifikimin dhe analizën e problemeve dhe oportunitetëve;
- formulimin e strategjive rajonale të shërbimit këshillimor dhe planeve vjetore;
- testimin dhe demonstrimin e teknologjive të reja nëpërmjet kërkimit në fermë;
- përgatitjen dhe përhapjen e mesazheve teknike;
- rritjen e vëmendjes për rolin e gruas në prodhimin në fermë;
- sigurimin e informacionit përkatës për inputet, marketingun, kreditin etj.

Rritjes së kapacitetit të trajnimit në të gjitha nivelet e shërbimit këshillimor do t'i shërbejë ngritja e një qendre trajnimi gjysmëprivat mbi bazën e kursit ekzistues në kuadrin e programit AVATAR në Departamentin e Shërbimit Këshillimor dhe Edukimit Bujqësor në Universitetin Bujqësor.

Trajnimi do të fokusohet në aspekte të përgjithshme të shërbimit këshillimor, buxhetin e fermës, menaxhimin, marketingun, metodat e vlerësimit, menaxhimin e stafit, si dhe futjen e koncepteve bashkëkohore në këtë fushë.

-Gjithashtu një mbështetje më e madhe do t'u jepet shërbimeve këshillimore private paralelisht me strukturat publike. Objektivi do të jetë transferimi gradual i përgjegjësisë së përhapjes së njohurive bujqësore, sektorit privat.